




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-16004/24 datë:27.06.2024



Npi – 01/237 datë: 04.07.2024

Duke u bazuar në Nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 5.4.4, dhe nenin 8.1 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, Zyra e Kryetarit me shkresën Nr.02/708 të datës 28.06.2024 i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi vendimin për subvencionimin e veçantë për Familjet Strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 04.07.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN NGA 100 € NË MUAJ PËR FAMILJET E KOMUNËS SË SHTIMES QË STREHOJNË FËMIJË PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -VII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 04.07.2024, unanimisht miratoi, Vendimin për ndarjen nga 100 € për ç'do muaj, për secilën familje që ka strehuar fëmijë pa përkujdesje prindërore në Komunën e Shtimes, deri më 31.12.2024.

II

Të drejtën mbi bazën e këtij vendimi e gëzojnë të gjitha Familjet e Komunës së Shtimes që kanë strehuar një ose më shumë fëmijë pa përkujdesje prindërore, mbi bazën e kërkesës që do ta paraqet familja në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas kriterëve që duhet plotësuar. Kohëzgjatja e pagesës është 6 muaj duke filluar nga data 01.07.2024 deri më 31.12.2024.

III

A r s y e t i m: Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes për subvencionimin e Familjeve Strehuese, është miratuar nga anëtarët e Kuvendit, aipas propozimit të Kryetarit të Komunës, duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/229 të datës 02.07.2024, si dhe mbi bazën e zotimeve për ta ndihmuar këtë kategori të familjeve në programin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nga shuma e planifikuar 122,734 euro për Subvencione dhe Transfere në DSHMS.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi